



International
Labour
Organization

Projekti “Adresimi në Nivel Lokal i Sfidës së Punësimit të të Rinjve në Shqipëri”

THIRRJE PËR APLIKIME

Gjenerimi i punësimit nëpërmjet zhvillimit të prodhimit të gështenjës në rajonin e Kukësit

1. Vështrim i përgjithshëm

Projekti për Adresimin në Nivel Lokal të Sfidës së Punësimit të të Rinjve i financuar nga SDC (Agjensia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim) vlerëson rolin kyç që autoritetet rajonale/lokale mund të luajnë në trajtimin e sfidave të tregjeve lokale të punës, si edhe masat e ndërmarra nga institucionet qendrore. Bazuar në eksperiencën e mëparshme në kuadrin e Projektit të Përbashkët të OKB për Punësimin dhe Migrimin e të Rinjve (PMR), kjo ndërhyrje synon konsolidimin dhe zgjerimin e përfshirjes së komuniteteve lokale në përpjekjet për zgjidhjen e problemeve të papunësisë. Paktet Territoriale të Punësimit (PTP) përfaqësojnë një risi institucionale e cila është e bazuar në konsultime dhe në planifikim të negociuar midis aktorëve publikë dhe privatë në nivel kombëtar dhe lokal, aktorë të cilët bashkohen për hartimin e objektivave të punësimit duke e vënë theksin tek formalizimi i punëtorëve të rinj dhe krijimi i vendeve të punës.

Paktet projektohen si partneritete nga poshtë-lart me qëllim që të nxisin iniciativat dhe skemat që e trajtojnë papunësinë që në rrënjë. Në të njëjtën kohë masat e PTP-së mbështesin politikatat të cilat shënjestrojnë zhvillimin dhe formalizimin e sektorit të bujqësisë duke promovuar formalizimin e ndërmarrjeve të vogla (mikro), veçanërisht në zonat e thella.

Ngritja dhe funksionimi i Bordeve Rajonale të Punësimit, të cilët institucionalizojnë rrjetet e aktorëve lokalë, e rrit besimin në lidhje me mundësinë e përsëritjes së këtij modeli përtej kohëzgjatjes së projektit. Modeli i PTP, si instrument efikas i cili mundëson nxitjen e mënyrave të reja të bashkëpunimit dhe ndërveprimit, është duke u rimarr në qarkun e Kukësit dhe Shkodrës dhe po testohet për herë të parë në qarkun e Lezhës. Qasjet e reja ndaj problemit kompleks të papunësisë, njohuritë teknike mbi praktikatat lokale dhe mësimet e nxjerra mund të shërbejnë edhe përtej kohëzgjatjes së Projektit dhe gjithashtu mund t’ju vijnë në ndihmë edhe aktorëve dhe subjekteve të tjera vendore, të cilët synojnë të kryejnë ndërhyrje të të njëjtit lloj.

Si pjesë e Paktit Territorial të Punësimit, një nga aktivitetet e veçanta për rajonin e Kukësit është kultivimi dhe grumbullimi i gështenjave si burim alternativ për punësim në zonat rurale, aktivitet i cili synon mbështetjen e punësimit të të rinjve nëpërmjet grumbullimit dhe tregtimit të gështenjave në Komunën Petkaj– Malzi.

2. Aktivitetet

Gështenjat përbëjnë një burim të rëndësishëm në rajonin e Kukësit; megjithatë, përdorimi i tyre është i kufizuar vetëm tek përpunimi i tyre për nevoja familjare nga ku vetëm një pjesë e vogël e këtij prodhimi hidhet në treg. Grumbullimi dhe tregtimi i gështenjave është i rëndësishëm për gjenerimin e mundësive sezonale për punësim si edhe për rritjen e të ardhurave të familjeve rurale. Qarku i Tropojës ka arritur të pilotojë me sukses teknikat e reja për kultivimin e gështenjave, gjë e cila mund të rimerret/aplikohet edhe në qarkun e Kukësit. Komuna Malzi është treguar plotësisht e gatshme dhe e angazhuar për lejimin e përdorimit të tokës në zonën e Petkaj nga banorët e zonës në mënyrë konkurruese. Kjo zonë ka një kapacitet prodhimi prej afërsisht 700 ton në vit.

Aktivitetet e mëposhtme synojnë arritjen e objektivave të kësaj mase:

1. Identifikimi dhe përzgjedhja e 10 të rinjve (meshkuj/femra) të moshës 15-29 vjeç, banues në komunën Malzi të cilët janë të interesuar për përdorimin e teknikave të reja për kultivimin e gështenjave si edhe për tregtimin e tyre duke e parë atë si një burim shtesë të ardhurash.
2. Ofrimi i trajnimit për 10 të rinjtë e identifikuar në lidhje me teknikat e kultivimit, grumbullimin, ruajtjen dhe tregtimin e gështenjave. Trajnimi teknik do të plotësohet edhe me trajnim mbi sipërmarrjen.
3. Të rinjtë e trajnuar do të inkurajohen/nxiten për ngritjen e deri në dy ndërmarrjeve. Personat e interesuar (në grup të përbërë nga 2 veta e lart) do të përfitojnë marrjen e një fondi për blerjen e mjeteve/tubave për magazinimin e gështenjave (deri në 2,000 dollarë për ndërmarrje) si edhe një stimul fillestar 1,500 dollarë për secilën kompani në momentin e regjistrimit ligjor të subjektit. Në rast paraqitjeje të më shumë se 2 plane biznesi, atëherë projekti do të mbështesë 2 projektet më frytdhënëse.

3. Modalitetet e përzgjedhjes

Identifikimi dhe përzgjedhja e 10 të rinjve të interesuar për përdorimin e teknikave të reja për kultivimin e gështenjës si edhe për tregtimin e saj si një burim shtesë të ardhurash do të kryhet nëpërmjet kësaj thirrje për aplikime.

10 të rinjtë e përzgjedhur do të trajnohen në lidhje me teknikat për kultivimin e gështenjës, grumbullimin, ruajtjen si edhe tregtimin e saj. Trajnimi teknik do të plotësohet edhe me trajnim mbi sipërmarrjen.

Personat e trajnuar do të mbështeten nga ofruesi i trajnimit në lidhje me formalizimin e kushteve për përdorimin e tokës komunale për kultivim të gështenjës.

Pas lëshimit të autorizimit nga komuna Malzi për përdorimin e tokës, ofruesi i trajnimit do të asistojë 10 personat e trajnuar për krijimin e maksimumi 2 subjekteve ekonomike të cilat mund ta bëjnë biznesin e ri edhe më të qëndrueshëm.

Në rast se personat e trajnuar do të dëshironin të ngrinin/krijonin më shumë se dy kompani, atëherë projekti do të mbështesë atë që është më frytdhënës. Përzgjedhja do të bëhet nga një panel ad-hoc, i emëruar nga Këshilli Rajonal i Kukësit dhe i përbërë nga një përfaqësues i Qarkut, një përfaqësues nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë në Kukës si edhe një përfaqësues nga projekti.

4. Pjesëmarrësit e mundshëm

- Aplikantët duhet të jenë banues në komunën Malzi;
- Janë të rinj të papunë (meshkuj/femra) të moshës 15-29 vjeç;
- Janë të gatshëm për t'u angazhuar në përdorimin e teknikave të reja për kultivimin e gështenjës si edhe tregtimin e saj si një burim shtesë për gjenerimin e të ardhurave të tyre;
- Janë të gatshëm për të ndjekur trajnimin specifik;
- Janë të gatshëm për t'u bashkuar me pjesëmarrësit e tjerë për krijimin e një subjekti të veçantë ekonomik për menaxhimin/drejtimin e biznesit të ri;

Afati i fundit: Aplikimet (si formulari a. ashtu edhe formulari b.) duhet të dorëzohen me postë ose dorazi në 2 (dy) kopje jo më vonë se dita e enjte, datë 20 mars 2014 në orën 12.00 në adresën e mëposhtme:

Z. Bukurosh Onuzi
Koordinator Rajonal për Kukësin
Adresa: Këshilli Rajonal i Kukësit
E-mail: buabon@yahoo.com
Cel: +355 692096645